

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
REGULATORNI AUTORITETI ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE  
REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS ARKEP

Nr./Br./No. 26512/19  
Nr. Faq./Br. St./No. Pg. 5  
Datë/Datum/Date 25.04.2019  
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISHTINA

AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN  
ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE  
Nr. 158 Prot.  
Datë 25.4.2019

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET**

**AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË  
KOMPJUTERIKE (AKCESK)**

**DHE**

**AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE  
POSTARE (ARKEP)  
NJËSIA NACIONALE PËR SIGURI KIBERNETIKE TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS (KOS-CERT)**

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (në vijim referuar si AKCESK), për qëllim të kësaj marrëveshje bashkëpunimi përfaqësohet nga drejtori i përgjithshëm Znj. Vilma Tomço,

Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - Njësia Nationale për Siguri Kibernetike (KOS-CERT) të Republikës së Kosovës, për qëllim të kësaj marrëveshje bashkëpunimi përfaqësohet nga Kryetari i Bordit z. Kreshnik Gashi,

në vijim referuar si “Palët”, ose individualisht si “Pala”,

Në zbatim të Ligjit nr. 2/107 “Për sigurinë kibernetike”

Ligjit nr. 107/2015 “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara”, i ndryshuar,

Ligjit nr. 9880/2008 “Për Nënshkrimin Elektronik”, i ndryshuar

si dhe,

Në zbatim të Ligjit nr. 04/I-109 për Komunikimet Elektronike (*Gazeta zyrtare nr. 30/2012*)

Në përputhje me mandatat e tyre përkatëse, bashkëpunimi ndërmjet dy autoriteteve do të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të ofrimit të ekspertizës, mbështetjes operationale dhe teknike në fushën e sigurisë kibernetike, ndaj palët kanë vendosur të konkludojnë marrëveshjen e mëposhtme,

Neni 1  
Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është krijimi i një kuadri bashkëpunimi midis palëve, duke identifikuar fushat e bashkëpunimit në bazë të interesit të përbashkët dhe duke vendosur objektivat dhe parimet e këtij bashkëpunimi.

Neni 2  
Fushat e bashkëpunimit

Palët bashkëpunojnë duke shkëmbyer ekspertizë dhe praktikat më të mira në fushën e sigurisë kibernetike, në veçanti në fushat e mëposhtme:

- a. Shkëmbim informacioni
- b. Bashkëpunim teknik
- c. Çështje strategjike dhe administrative
- d. Fusha të tjera të identifikuara si të rëndësishme reciprokisht

Neni 3  
Shkëmbimi i informacionit

1. Palët bien dakord, aty ku është e përshtatshme, të shkëmbejnë informacionet e mbledhura dhe të përpunuara, statistikave, analiza dhe raporte, në përputhje me aktet e tyre themelore ligjore, aty ku është e aplikueshme. Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" nuk është parashikuar dhe është jashtë fushëveprimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
2. Gjatë shkëmbimit të informacionit, statistikave, analizave dhe raporteve, do të ndiqen procedurat përkatëse të brendshme të Palëve.
3. Palët bien dakord, aty ku është e përshtatshme, të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informacionit mbi gjetjet apo raportimet që rezultojnë nga monitorimi i ngjarjeve kibernetike, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë në nivel Kombëtar.
4. Shkëmbimi i informacionit mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në:
  - a. Vëzhgimet dhe gjetjet e përgjithshme që rezultojnë nga aktiviteti i njëres Palë, që mund t'i shërbejnë punës së Palës tjetër;
  - b. Shkëmbimi i praktikave, mjeteve dhe rekomandimeve më të mira që mund t'u ndihmojnë palëve për të forcuar bashkëpunimin e tyre në fushat që mbulohen nga Memorandumi i Mirëkuptimit.

Neni 4  
Bashkëpunimi teknik

1. Palët do të përpiqen të përmirësojnë bashkëpunimin e tyre në kontekstin e reagimit ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike dhe në veçanti në lidhje me aktivitetet dhe procedurat e brendshme të parashikuara nga secila Palë.
2. Palët kanë për qëllim, në veçanti, të bashkëpunojnë duke identifikuar dhe vepruar në fushat me interes të përbashkët dhe kërkime të përbashkëta.
3. Palët, brenda kufijve të mandateve të tyre përkatëse, mund të angazhohen në bashkëpunim të mëtejshëm që kanë vlerë të shtuar dhe është në interes të ndërsjellë të Palëve.

Neni 5  
Bashkëpunimi strategjik


1. Palët bien dakord të konsultohen me njëri-tjetrin, kur është e nevojshme, gjatë përgatitjes së dokumenteve strategjike, të tilla si strategjitë dhe planet e veprimit në fushat e bashkëpunimit të identifikuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi.
2. Secila palë, aty ku është e përshtatshme, mund të ftojë Palën tjetër që të marrë pjesë në aktivitetet e saj të planifikimit për të siguruar konsultimin dhe koordinimin e aktiviteteve përkatëse.

Neni 6  
Çështjet administrative

Palët bien dakord, kur është e përshtatshme, të bashkëpunojnë në çështjet administrative duke ndarë përvojën, ekspertizën dhe praktikat më të mira, duke përfshirë fushën e menaxhimit të cilësisë dhe riskut të sigurisë kibernetike.

Neni 7  
Konfidencialiteti dhe siguria

1. Secila Palë merr përsipër të ruajë konfidencialitetin e çdo informacioni, dokumenti ose materiali tjetër të ofruar nga Pala tjetër, të mos e ndajë atë me palë të treta pa pëlqimin paraprak me shkrim të asaj Pale dhe të mos përdorë informacionet për qëllime të tjera jashtë zbatimit të këtij Memorandum Mirëkuptimi.



2. Secila Palë do të sigurojë që informacioni i ofruar ose shkëmbyer sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi të jetë i mbrojtur sipas rregullave të tyre përkatëse të sigurisë dhe parimeve përkatëse.
3. Pala që furnizon informacionin mund të tregojë, në momentin e sigurimit të informacionit, çdo kufizim në aksesin ose përdorimin e tij, në kushte të përgjithshme ose specifike, duke përfshirë transferimin ose fshirjen e tij.
4. Palët bien dakord të bashkëpunojnë, sipas rastit, në fushën e sigurisë, veçanërisht në lidhje me masat e nevojshme për mbrojtjen e informacionit sensitiv, nëpërmjet konsultimit, mbështetjes së ndërsjellë ose shkëmbimit të praktikave më të mira.

Neni 8  
Komunikimi i palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre në formë shkresore dhe/ose me e-mail zyrtar.
2. Palët do të caktojnë, në përputhje me rregullat dhe procedurat e tyre të brendshme, pikat e kontaktit të përshtatshme për zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Pikat përkatëse të kontaktit do t'u komunikohen Palëve të tjera brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas nënshkrimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 9  
Ndryshimet e Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet ose plotësohet në çdo kohë nga pëlqimi i ndërsjellë midis Palëve.
2. Të gjitha amendamentet dhe plotësimet do të bëhen me shkrim. Ato do të hyjnë në fuqi ditën pas nënshkrimit nga Pala e fundit.

Neni 10  
Afati i marrëveshjes

1. Secila nga Palët mund të ndërpresë angazhimin e saj sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, duke i dhënë njoftim me shkrim tre muaj para Palës tjetër.
2. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të mbetet në fuqi ndërmjet Palëve deri në një kohë kur ata të dorëzojnë njoftimin e tyre me shkrim për përfundimin e tyre në përputhje me pikën 1 të këtij neni.




Neni 11  
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët

Nënshkruar në Tiranë, më 25/04/2019, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

**AUTORITETI KOMBËTAR PËR  
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE  
SIGURINË KOMPJUTERIKE  
(AKCESK)**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
Dr. VILMA TOMÇO



**AUTORITETI RREGULLATIV I  
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE  
DHE POSTARE (ARKEP)**

**Njësia Nacionale për Siguri Kibernetike  
(KOS-CERT)**

KRYETAR I BORDIT  
Z. KRESHNIK GASHI

